



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 10.07.2024

NR.09/ 5853 /2024

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-24-5165-2-3-6/C541 & KKHE-24-024-2-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"EUROPLUS" SH.P.K, Lagja e Re, Veli Ballazhi, HANI I ELEZIT, 601550462, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Mirembajtja e kanalizimit fekal dhe atmosferik me numër identifikues: 659-24-5165-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Mirembajtja e kanalizimit fekal dhe atmosferik

No.	Lot
1	Mirembajtja e kanalizimit fekal dhe atmosferik

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 9,207.00 €; [Nëntë mijë e dyqindë e shtatë euro /0 cent] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4**Komunikimet**


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie të ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	10.07.2024
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve "EUROPLUS" SH.P.K

Emri:	Nermin Osmani
Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:	
Data:	10.07.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-24-5165-2-3-6/C541

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është [10.07.2024].
	6.4	Data e Përfundimit është [09.07.2025].
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është [Ne zone urbane dhe zona rurale te Hanit te Elezit –sipas nevojës.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është Do te caktohet me vendim te veqant te ZKA-së.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% në ditë për shërbime të parealizuara Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është [10%] të çmimit final të kontratës
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vleres se kontrates me afat prej 13 muajve.
Masat që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15	Çdo mos përmbushje e kushteve të kontrates nga ana e Operatorit ekonomik, nga AK do të merren masa sipas Ligjit – penalizimet për vonesat në rast se 3 ditë radhazi nuk përgjigjet do të shkeputet kontrata njeanshem. Zyra e prokurimit ka të drejtën e Inspektimit cdo ditë dhe në rast se vërtetohet e kundërta do të merren masa.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pagesa do të behet pas realizimit të shërbimit i pranuar nga AK-ne cilesi dhe sasi. Pagesa do të behet brenda afatit ligjor.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur Menaxheri i kontrates kontrollon cilesinë dhe sasinë e realizimit të shërbimit –meremetimi i tavanit konform paramases se dhenë ne ofertë..
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose permes procedurave alternative të zgjidhje se mosmarrëveshjeve-procedurat e ndërmjetësimit me pajtimin e të dy palëve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Komerciale – Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].